



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 42 datë 27.7.2021

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 61, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ATO INDIVIDË/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 27.7.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje nenit 24 pika 2, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; neni 39, pika 3 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendor; VKM nr. 362 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij“; VKB nr. 63 datë 28.12.2020“Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021-2023 të Bashkisë Shkodër” i ndryshar ; “Procesvebalit përfundimtar të Komisionit të Strehimit nr.2475/b/1 prot. datë 16.07.2021 “Miratimin e ndryshimit të përfitueses Rudina Emini me Albert Sadiku tek Lista e përfituesve subvencionimi të qirasë nga buxheti i Bashkisë të miratuar me VKB nr. 61. datë 28.12.2020 “Për miramin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në treg të lirë”, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e VKB nr. 61, datë 28.12.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lire, sa i takon zëvendësimit përfitueses Rudina Emini me përfituesin Albert Sadiku tek ‘Lista e përfituesve të subvencionimit të qirasë me

burim financimi nga buxheti i Bashkisë të miratuar me VKB nr. 61, datë 28.12.2020.’

2. Kohëzgjatja e subvencionimit së qirasë për përfituesin sipas pikës 1, do të jetë për periudhën e mbetur pa likuiduar dhe nga data e lidhjes së kontratës së qirasë, sipas tabelës bashkëngjitur.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej 129,375 (njëqind e njëzet e nëntë mijë e treqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë, do të përballohen nga fondi i përcaktuar të buxhetit të Bashkisë Shkodër, të miratuar me VKB nr. 26 datë 30.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2023 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar (programi buxhetor: 10661 (Strehimi Social), projekti: P10661.O2.A1).
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 27 vota

Vota Pro 27

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 2.8.2021

Tabelë përmbledhëse:

Emër	Atësi	Mbiemër	Përbërja Familjare	Struktura e Apartamenti	Sipërfaqja	Qiraja mesatare	Tëardhurat Familjare mujore	Kateg.	Aftësia përballues	Qiraja e përballuash me	Subvencioni /muaj	Subvencioni oni/vit	Vlera e subvenci onuar
Rudina	Osman	Emini	4	2+1	58 m ²	17,250	0	ç	0%	0	17,250	207,000	77,625

Ndryshimi I përfituesit dhe vlera e subvencionimit të mbetur për likuidim:

Emër	Atësi	Mbiemër	Përbërja Familjare	Struktura e Apartamenti	Sipërfaqja	Qiraja mesatare	Tëardhurat Familjare mujore	Kateg.	Aftësia përballuese	Qiraja e përballuash me	Subvencioni / vit	Subvencioni oni/muaj	Vlera e mbetur për të subvenci onuar
Albert	Shaqir	Sadiku	4	2+1	58 m ²	17,250	0	ç	0%	0	17,250	207,000	129,375



Handwritten signature in blue ink.